



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI.**

**Sesioni Pranveror**

**Komisioni për Integrime Evropiane**

**Mbledhja nr. 23.**

**Prishtinë, më 03.07. 2018 në ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303**

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Blerta Deliu- Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Donika-Kadaj-Bujupi, Milaim Zeka, Ismajl Kurteshi dhe Fatmire Kollçaku.

**Munguan:** Fikrim Damka, Ilir Deda, Adem Hoxha dhe Visar Ymeri.

**E ftuar:** Dhurata Hoxha- Ministre e Integritimit Evropian;

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit të tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ, OSBE-së, NDI, KDI, Zyra e BE-së dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit**

**Kryetarja**, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e komisionit me këtë

**Rend Dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.06.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në Kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistencë Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian- e ftuar;**

4. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores së Kuvendit, me amendamentet e komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua i pa ndryshuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.06.2018;

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në Kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistencë Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian, e ftuar: Ministria për Integritime Evropiane, Dhurata Hoxha

**Kryetarja**, tha se kemi ftuar ministren për Integritime Evropiane për të prezantuar Ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në Kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistencë Teknike në kontekst të Integritimit Evropian.

**Ministria për Integritime Evropiane, Dhurata Hoxha**, lidhur me marrëveshjen theksoi se procesi i integritimit është kompleks, prandaj kapacitetet institucionale janë ndër faktorët kyç. MIE në bashkëpunim me institucionet tona dhe Zyrën e BE-së ka identifikuar një numër të fushave të MSA-së apo kapitujve të Acquis ku do të kontribuohet në forcimin e kapaciteteve. Qëllimi është zbatimi efikas i MSA –së dhe zbatimit të agjendës evropiane në mënyrë që të jemi të gatshëm për fazat e ardhshme të integritimit. Për disa muaj është negociuar kjo marrëveshje dhe kemi arritur që me 7 mars ta nënshkruajmë një marrëveshje të bashkëpunimit mes Qeverisë së Luksemburgut në kontekst të integritimit evropian për mbështetjen e institucioneve të Kosovës në zbatimin e MSA-së në disa fusha parësore.

Asistenca afrohet për trajnim, trajnim të trajnerëve dhe nevoja ad-hoc për ekspertizë dhe politikave të caktuara dhe hulumtimi gjithëpërfshirës i politikave të BE-së për të ndihmuar në formulimin e politikave nacionale dhe përafrimin e legjislacionit.

Fushat parësore bazohen në prioritetet e MSA dhe përfshin 10 fushat e politikave, prej të cilave 9 janë kapitujt e Acquis dhe një temë horizontale. Institucionet përfutuese janë Ministria për Integritim evropian, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Tregtisë dhe industrisë, Ministria e Kulturës dhe Rinisë, Ministria e drejtësisë, Gjykata dhe Prokuroria, Ministria e Administratës Publike, KGJK, KPK KRPP, OSHP, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës etj.

Projekti planifikohet të realizohet për 4 vjet dhe shuma e mbështetjes është 2.1 Mil.€ prej të cilave Luksemburgu jep grand prej 2 Mil.€ dhe bashkëfinancimi nga MIE është 100 mi € Projekti do të menaxhohet nga komiteti i përbashkët drejtues-MIE dhe Luksemburgu dhe do të

implementohet nga MIE dhe për këtë është duke bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Financave, Thesarin dhe institucionet e tjera për të siguruar mbarëvajtjen e projektit.

Zbatimi i aktiviteteve konkrete planifikohet të nisë pas shtatorit me kusht që ligji të kalojë në Kuvend paraprakisht. Përveç që projekti ndihmon në forcimin e kapaciteteve për integrim evropian të institucioneve, projekti do të ndihmon edhe në forcimin e kapaciteteve të MIE për menaxhim dhe absorbim të fondeve dhe projekteve. Në kuadër të këtij projekti kam dërguar një letër që të plotësohet dhe ndryshohet kjo marrëveshje edhe me një përkrahje shtesë me ekspertë qoftë për ministri dhe Komisionin Parlamentar për Integritet Evropian, tani jemi në pritje të përgjigjes së tyre.

**Kryetarja**, tha se tani ju e dini që Kuvendi ka hyrë në një fazë të re të vendimmarrjes politike, pajtohem që marrëveshja si e tillë që të ketë përkrahje për shërbyesit civil, por duke marrë parasysh që vendimmarrja do të jetë politike, mendoj se duhet të ketë përkrahje edhe në aspektin e komisioneve parlamentare, sepse në fazën e re prej shtatorit do të intensifikohet puna në Kuvend dhe po ashtu nëse i shihni statistikën e fundit del se implementimi i MSA-së është 30% që nuk është shifër inkurajuese për institucionet e Kosovës dhe mendoj që do të duhet të ketë një rekomandim që marrëveshja si e tillë të ketë një vëmendje të shtuar sa i përket ekspertizës dhe mbështetjes edhe të nivelit politik.

**Armend Zemaj**, theksoi se është e rëndësishme përmbushja e kriterëve teknike sa i përket obligimeve që dalin për zbatueshmërinë e ERE-së dhe zbatimin e MSA-së, por edhe pjesa politike pavarësisht lëvizjeve dhe raporteve politike që i ka Republika e Kosovës interesimi i përbashkët është që të ecim tutje dhe kjo pjesë që ndihmohet nga miqtë evropian është e domosdoshme që të ketë edhe impaktin e vet në implementim. Kur nuk je negociues i marrëveshjes nuk i din detajet saktësisht, por duket që pjesa politike është e anashkaluar dhe arsyeshmërinë mund ta jepni ju ministre dhe mund të na sqaroni lidhur me letrën e dërguar për kërkesë shtesë apo rinegocim, sepse në pjesën përfundimtare pasi të hyjmë në obligime ndryshimi i marrëveshjes kërkon prapëseprapë konsultim me çdo palë nga komuniteti drejtues që ju mund ta arrini.

Marrëveshja si e tillë nga ajo që shihet është e favorshme për Republikën e Kosovës, por sa do të ketë impakt që pjesa teknike dhe politike të kenë një bashkërendim dhe përfitim nga këto dispozita që janë të shkruara, mendoj se janë të pakta kështu siç është kjo pjesë e marrëveshjes, mendoj se qëllimet që janë paraqitur në marrëveshje nuk mund ta arrijnë efektin e duhur. Ju jeni palë e negociimit, kurse ne jemi palë e vlerësimit dhe e votimit, por mendoj që nëse është e mundur dhe nëse ju mund ta realizoni duhet të ketë një rinegocim për të dy pjesët që i përmenda.

Si objektivi i kësaj marrëveshje është integrimi më i shpejtë edhe si ndihmë në strukturat evropiane si pjesë e punës së përditshme që ka MIE dhe bashkërendimi që bëhet me Komisionin për MSA-në .

Nuk e shoh efektin e qindtë për qindtë në atë që shkruan te qëllimi i kësaj marrëveshje në mënyrën e përfitimit të palëve që janë pjesë e implikuar në këtë proces. Tash ne do ta shqyrtojmë pjesën e obligimit tonë si Komision, por prapë është mendimi që mos të shkojmë

me logjikën që prej pozicionit si pjesë e opozitës që mund ta kërkojmë një suspendim, por të ju japim juve mundësinë nëse dëshironi që për një kohë të tentoni ta rinegocioni pjesën ku ndërlihet me impaktin politik të asistencës e cila është drejtpërdrejt nga alokimi i këtyre fondeve.

**Donika Kadaj Bujupi**, Pas prezantimit tuaj ministre mu duk që u kthjem për 10 vjet pas në ato fazat e trajnimeve. Kosova të paktën ishte dashtë me e kaluar këtë fazë ose kur negociojmë marrëveshje të tilla me qenë ma specifik në nevojat dhe kërkesat tona. Thënë të drejtën ne nuk kemi mbërritur që pas 19 viteve pas luftës me e kaluar fazën emergjente dhe me i ngritur disa kapacitete krejt bazike, p.sh. ne absorbimin e projekteve me një ekip që është në gjendje me apsorbuar fonde qoftë të IPA-së dhe fonde tjera ndërkombëtare, atëherë mund të them se jemi shumë vonë, propozoj që të jemi pak më konkret dhe ta emërtojmë problemin. Mendoj që në marrëveshjen e MSA-së kishte me qenë me adekuate të kemi propozime konkrete që kishin mundur me u përkthye në një marrëveshje, e cila p.sh. do t'i përkrahte bujqit në themelimin e një fondi i cili nuk do të kishte kamata te larta siç i kanë bankat, ose nëse flasim për përkrahjen e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, ne vazhdojmë edhe sot me pas monopol tek aviokompanitë dhe vazhdojmë me pas biletat më të shtrenjta dhe ky autoritet kur nuk vepron. Ne në Kuvend me dhjetëra herë kemi kërkuar me pas një hetim se çka po ndodh se a kanë mbërritur me e hetuar ndonjë monopol, ose kur flasim te absorbimi i projekteve në prioritetet edhe të BE-së edhe tonat, p.sh. janë gratë, pronat dhe mundësitë që edhe ato të kenë qasje në pronë dhe trashëgimi, kemi ngecë edhe këtu , dihen shifrat prej 2-3%, e kemi diskutuar disa herë ne Parlament, por nuk kemi bërë ndonjë lëvizje përpara. Mendoj se duhet me qenë ma konkretë dhe specifik, e kemi kaluar fazën emergjente, por për trajnime, trajner të trajnimeve me i marr 2 milionë dhe me i harxhuar nja 100 milionë , në fund me na thënë se janë paguar 2-3 ekspert, çka ka fituar Kosova, por të paktën nëse ka fituar politikisht ta dimë atë pjesë, por këtu nuk po duket se as politikisht nuk e kemi ndonjë përfitim të caktuar.

**Milaim Zeka**, tha se diskutimi im do të jetë në vazhdimësi në diskutimet e dy parafolësve dhe si deputet i parlamentit do t'i shpreh disa brengat që do t'i bazoj në fakte dhe disa shqetësime të mia që do t'ju shërbejnë juve ministre si këshilla në takimet e juaja me zyrtar të Brukselit dhe çdo vendi tjetër. Kam një përvojë në punën e këtyre marrëveshjeve dhe fondeve të cilat për fatin e keq janë keqpërdorur shumë, sepse na konsiderojnë si shumë të pa dijshtëm. Sa herë që i takoj diplomatët e huaj, qoftë në Prishtinë apo në vende të ndryshme e shprehi këtë shqetësim dhe asnjëherë nuk me kundërshtojnë. Para pak kohësh isha në një vizitë jashtë vendit dhe ju kamë thënë, nëse ju vërtet doni me e luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në Kosovë duhet të dini se qytetarët e Kosovës nuk janë të përfshirë, por janë te përfshirë të gjitha strukturat e shtetit, pra njerëzit brenda këtyre strukturave, jo të gjithë, por individ. Atëherë pse këta nuk e bëjnë listën kujt me ju refuzuar vizat për mos me pasur të drejtë për lëvizje të lirë, e jo me i lënë qytetarët e Kosovës pa viza, kjo është e pa drejtë. Lirisht mund të them se në Evropë ka ekzistuar dhe ekziston një farë racizmi i heshtur i mbështjell me islamofobi. Kosova dhe Shqipëria janë duke u dënuar vetëm sepse nga zyrtarët e lartë të BE-së dhe vendeve te

ndryshme evropiane konsiderohen si islame, ky është një fakt dhe e vërtetë sepse nuk guxojnë me e thënë publikisht për shkak të opinionit të tyre të brendshëm.

Çdo zyrtar i lartë evropian e dinë se për çdo korrupsion dhe krim të organizuar stafetën qendrore e kanë bartë ndërkombëtarët në Kosovë. Do të ndalem në një projekt i cili ka qenë në kohën e Agim Çekut, ministre mund të gjeni fakte dhe pastaj kur të takoheni me ambasadorin Suedeze dhe me ambasadorin anglez duhet t'i tregoni se DFID-i anglez së bashku me SIDE-në suedeze kanë qenë të përzier në një projekt madhor diku prej 2 milionë € dhe ky projekt është implementuar së bashku me Rinvestin, çka ka ndodhur këtu, 2 ekspertë anglezë që kanë marrë pagë ditore prej 1000€ dhe nuk kanë qenë fare në Kosovë për asnjë ditë dhe një profesor shumë i njohur hajdut të cilit nuk do t'ia përmend emrin, së bashku me hajdutet e tjerë ia ka nënshkruar raportin se gjoja ata kanë qenë dhe kanë marrë pjesë në implementimin e atij projekti. Lidhur me këtë ka reaguar ambasada suedeze dhe ka kërkuar që një pjesë e këtyre parave me u kthye mbrapshtë për shkak të keqpërdorimeve. Andaj ju ministre është mirë ta ngrisni pak zërin para tyre dhe me ju treguar se ne mund të implementojmë projekte pa ekspertë ndërkombëtarë sepse ne kemi ekspertë në Kosovë, djem dhe vajza shumë të talentuar dhe të shkolluar që njohin gjuhë të huaja. Në fund pyeti ministren se çka i thonë zyrtarët e lartë në Bruksel privatisht, se a kanë shpresë qytetarët e Kosovës se mund të udhëtojnë pa viza a jo?

**Zenun Pajaziti**, tha se lidhur me ratifikimin e marrëveshjes është rast i mirë me iu falënderua Qeverisë së Luksemburgut dhe të tjerëve që ende janë donatorë në Kosovë.

Në princip mendoj se ne këtë fazë ku jemi ende kemi nevojë si shtet i ri dhe administratë e re për asistencë teknike në aspektin e trajnimeve dhe edukimin e të rinjve. Ne kemi pas asistencë teknike vazhdimisht, por për shkak të mos koordinimit të mirë mes donatorëve dhe institucioneve vendore kemi pas dyfishim dhe shumëfishim të projekteve. Ne e kemi trajtua këtë temë dhe kemi kërkuar të këtë koordinim më të mirë, por besoj që ne këtë rast nuk do të ketë, ajo që është esenciale është që kur vijnë këto asistencë prej institucionit për ministrin adekuate të jenë për një temë që është prioritet për ne. Fokusi i këtij donacioni që po shoh është krijimi i një mekanizmi për trajnim dhe asistencë teknike për fuqizimin e burimeve njerëzore të administratës në Kosovë. Ne kemi investuar dhe ka pasur donacione ndërkombëtare në Kosovë në një institucion që është dizajnuar me trajnuar administratën publike në Kosovë, nuk e di tani se në çfarë gjendje është ky institucion. Mendoj se prapë po bëjmë të njëjtat gjëra, po japim dhe po marrim asistencë, po kemi trajnime në sektor të ndryshëm me të njëjtët njerëz, ndërsa po na mungon një mekanizëm i qëndrueshëm që vazhdimisht kishte me i trajnuar sektorët e ndryshëm të administratës publike dhe në këtë e kemi lënë anash nuk e kemi zhvilluar, mendoj se me këtë donacion ju ministre së bashku me ministrin e Administratës Publike e keni një shans me e ringritur këtë institucion me bërë të qëndrueshëm për vitet në vijim.

**Fatmire Kollçaku**, tha se tani gjendemi në një fazë që kur na jepet një asistencë të jetë në kuptimin në atë se te ne na pyesin neve se për çfarë trajnimesh kemi nevojë.

20 vjet janë derdh mjete të pa fundme për trajnimin e stafit, fatkeqësisht shpesh kanë qenë staf politik që janë trajnuar dhe që janë emëruar në poste që nuk është dashtë dhe pastaj ata kanë shkuar me ministra. Pastaj kanë ardhur të tjerët dhe kështu janë trajnuar pafundësisht,

bile- bile edhe janë shkolluar, për derisa shumë studentë tanë janë shkolluar me mjete vetjake, që njëherë janë kthyer, por prapë kanë shkuar në Evropë, sepse nuk po shohin perspektivë me u kthye në vend me kontribuar.

Nuk ju fajësoj juve ministre, por është një politikë e pasluftës që fare nuk janë inkurajuar ata të rijnë të kthehen në vendin e vet. Ministrinë janë të stërmbushur me ata te cilët kanë ardhur nga politika dhe jo me aftësitë e veta dhe ne jemi në një fazë, ku donatorët po na akuzojnë që ju nuk po dini me i shpenzuar mjetet .Ne e kemi sot një sistem shëndetësor jo funksional dhe auditori ka gjetur shumë shkelje aty dhe pikërisht është fondi që e ka dhënë Luksemburgu aty dhe rrjedhimisht deshëm apo nuk deshëm ato janë të ndërlidhura .

Fatkeqësisht janë derdhur shumë mjete për trajnimin e shumë njerëzve, por shumë nga ata nuk janë duke punuar, andaj ne duhet t'i shohim se ku janë ata njerëz, në të cilët është investuar dhe nuk shfrytëzohen, e jo te investohet nga fillimi ne njerëz te rinj. Në fund pyeti ministren se a ka lëvizje në drejtim të liberalizimit të vizave? Ne e dimë që ka qenë drejtoresha e Ballkanit perëndimor në takim me Komisionin e Punëve të Jashtme ku i ka dhënë vërejtjet e veta, do të thotë se ata janë duke na vëzhguar në veçanti për reformën në administratën publike.

**Ismajl Kurteshi**, mendon se për projektet e tilla ka nevojë për dy arsye, sepse tha se ne sado që dimë, kemi nevojë për njohuri të reja dhe arsyeja tjetër është se në Kosovë janë shpenzuar qindra milion € për trajnime dhe pjesa me e madhe e këtyre projekteve kanë qenë fiktive sepse trajnimet ose janë mbajtur shkel e shko, ose nuk janë mbajtur fare dhe pjesa me madhe e atyre mjeteve të cilat janë destinuar, si ndihmë Kosovës i janë kthyer prapë të ata që i kanë dhënë mjetet. Ne kemi pasur me qindra mijëra trajnime në fushën e arsimit dhe ne sot kemi probleme serioze si në cilësi dhe në shumë çështje të tjera, pastaj po ashtu kemi pasur shumë trajnime në shëndetësi dhe në menaxhim e shohim çfarë është gjendja ne shëndetësi dhe si po menaxhohet. Prandaj ajo që duhet të ndodhë është në përgjegjësinë tuaj ministre, që mos të lejoni që edhe këto mjete të shpenzohen për trajnime fiktive, por të shihen rezultatet, e meta e te gjitha këtyre trajnimeve që kanë ndodhur pas lufte është se askush askënd nuk e ka verifikuar se çka ka përfituar nga një trajnim dhe cilat janë rezultatet e trajnimeve, sa do shumë që jemi trajnuar prapë po dalim që nuk jemi mjaftueshëm të dijshëm për shumë çështje që ndonjëherë janë edhe elementare, është e vërtetë ajo çka u tha nga kolegu parafolës se shumë projekte nga ndërkombëtares sillen këtu për përfitime të tyre me shumë se tonat, duke na konsideruar si njerëz nën nivelin që ne vërtet e posedojmë.

Kosova me të vërtetë është ma e varfër dhe më e pa zhvilluar se pjesa tjetër e botës, por janë shumë gjëra që i dimë dhe nuk ka nevojë te investohet në gjërat që i dimë, por ne diçka të re që kanë nevojë gjeneratat tona të reja të mësojnë.

**Kryetarja**, i tha ministres ne, si komision, i kemi bërë disa amendamente gjuhësore, ne pajtohemi të gjithë që Kosova ka nevojë edhe me tej për trajnime, por natyrisht një definim i qartë i këtyre trajnimeve dhe destinimi i këtyre mjeteve do të ishte shumë i rëndësishëm për ne.

**Ministrja,** tha se edhe ne në ministri i kemi vërejtur këto mangësi, por fatkeqësisht nuk kemi qenë të kyçur në mënyrë të drejtë në negociim edhe pse mjetet do të derdhen në Ministrinë e Integritit Evropian, që është një sinjal i mirë për besimin që i është dhënë institucioneve të Kosovës, gjithashtu mendoj që ka hapësirë që të shohim se çka mund të plotësohet, sepse edhe rekomandimet e juaja ishin shumë të qëlluara. Pajtohem që kemi nevojë për trajnime, por njëkohësisht kemi nevojë që t'i inkuadrojmë të rinjtë tanë të cilët kemi investuar për shkollimin e tyre dhe tani mund t'i përdorim si kuadër brenda këtij projekti. E përmenda që unë e kam shkruar një letër ku kam kërkuar që të plotësohet dhe të ndryshohen termat e referencës sipas vijave të rekomandimeve tuaja që përfitimet të jenë për të rinjtë tanë.

Ndoshta edhe ju pajtoheni që ta kemi një hapësirë kohore që mos ta dërgojmë menjëherë për seancë që ta kemi mundësinë e plotësim ndryshimit dhe mirë e kemi vërejtur se edhe komisioni juaj dhe komisioni për MSA-në nuk përkrahet, pra duhet gjetur hapësirë që të përfshihen edhe këto dy Komisione shumë të rëndësishme sepse 2 mi € nuk janë pak.

Ne do t'ju informojmë për çdo hap dhe besoj se së shpejti do të keni një përgjigje pozitive.

Lidhur me pyetjet për liberalizimin e vizave tha, ta shfrytëzoj rastin dhe të ju informoj në lidhje me vizitën e fundit në Bruksel dhe disa vizita të tjera që i kisha, ne jemi në pritje të daljes së rekomandimit nga Komisioni Evropian, jemi optimist që rekomandimi do të jetë pozitiv ku pastaj institucionet e BE-së të lëvizin me hapa të tjerë të vendimmarrjes, gjithashtu duhet të sqarojmë se te gjitha vizitat që po bëhen, qoftë nga Parlamenti dhe nga ministrinë janë kërkesat tona legjitime që të llobojmë dhe të kërkojmë nga vendet anëtare të BE-së që procesi i vendimmarrjes të përshpejtohet. Nëse ka vullnet politik të shteteve anëtare të BE-së është reale të them se qytetarët tanë pritet të lëvizin të lirë deri në fund të vitit.

**Kryetarja,** Ne, si komision, e mirëpresim çdo informatë që lidhet me procesin e liberalizimit të vizave, besoj që në javët në vazhdim presim ta kemi një takim ku do të diskutojmë edhe për angazhimin e komisionit dhe angazhimin e ministrisë në proceset e ardhshme që pritet të hyjë vendi menjëherë pas marrjes së rekomandimit pozitiv.

**Donika Kadaj- Bujupi,** Falënderoj ministren për vullnetin për përfshirjen e Komisionit për Integritet Evropian në plotësimin e kësaj marrëveshje, pyeti se a rrezikohet marrëveshja nëse nuk ratifikohet në parlament në afatin e caktuar, sepse tha se deputetët nuk kanë refuzua një përkrahje të tillë.

Ajo çka u tha fillimisht është se herëve të tjera duhet ta negociojmë me hollësisht dhe me saktësisht në mënyrë që destinimi i mjeteve të jetë për projekte që përfitojnë drejtpërdrejt qytetarët e Kosovës, sepse faza emergjente e trajnimeve ka kaluar, e thatë edhe ju se tani kemi një rini e cila tashmë është në një fazë krejt tjetër, kemi të rinj në diasporë që mund t'ju jepet mundësia sepse janë potencial dhe mund t'i angazhojmë në projekte të caktuara të cilët i garojnë eksperteve ndërkombëtarë, kemi nevojë për një plan me konkret në mënyrë që ne në të ardhmen ta kemi më të saktësuar se ku do të shkojnë këto mjete. Te çështja e vizave tha se ne kemi pasur më së shumti kritere nga vendet e rajonit dhe kemi pasur kritere të padrejta dhe kemi pasur kërkesa më të mëdha politike se te gjithë te tjerët, prandaj në fazën të cilën jemi mendoj se është krejtësisht e pa drejt edhe zvarritja dhe vonesa e marrjes së raportit

përfundimtar që e kemi pritur të gjithë dhe presim ta marrim një përgjigje të shpejtë brenda pak ditëve.

Në fund tha se një agjendë e përbashkët me qeverinë dhe një përfshirje më e madhe e komisionit do të ishte ma progresive dhe do të jepte rezultat më të shpejtë për të gjithë.

**Kryetarja**, tha se së shpejti do ta kemi një takim të përbashkët me ministren Hoxha dhe ajo çka duhet të ceket është se Komisioni për Integritet Evropian dhe Parlamenti kanë një konsensus sa i përket agjendës evropiane dhe të gjithë jemi të interesuar të punojmë bashkërisht, në shumë shpejt presim që të dalim nëpër komunat e Kosovës për të diskutuar me qytetarë dhe pajtohemi me parafolësit që thanë se na duhet një koordinim më i mirë i Qeverisë bashkë me Parlamentin, andaj propozoj që së shpejti të takohemi dhe bashkërisht ta bëjmë një plan të punës dhe një agjendë të përbashkët me Ministrin e Integritetit Evropian.

**Milaim Zeka**, lidhur me iniciativën e kryetarit të Kuvendit për lobim në shtetet e BE-së tha se e përshëndet, por përbërja e delegacionit tha se është e gabuar sepse kanë shkuar njerëzit të cilët nuk kanë kompetenca dhe kurrfarë njohurish mbi BE-në dhe nuk kanë kontakte me njerëz brenda Parlamentit evropian dhe evropianët.

Kurse sa i përket Parlamentit tha se nuk është duke bërë asgjë dhe e ndijë veten shumë të turpëruar që jam deputet me këtë tempo që është duke i kryer detyrat e veta karshi qytetarëve të Kosovës, nuk po aprovohen ligjet, kemi ngecje shumë, kemi thirrje të seancave dhe interpelanca krejt pa lidhje, rezolutë pas rezolute, por gjërat esenciale nuk i kemi bërë.

Sa i përket trajnimeve tha se trajnimi më i nevojshëm që i nevojitet Kosovës është kënd me e përzgjedh me e trajnuar, sepse nuk trajnohen njerëzit e pa ditur sepse njeriu bazamentin e dijes e krijon në shkollë fillore dhe të mesme, universiteti është vetëm me i specializuar njerëzit për një drejtim, në pjesën dërmuese të ministrive janë të punësuar njerëz mbi baza familjare dhe partiake, se pari punësohen njerëzit pastaj hapen konkurset.

**Armend Zemaj**, tha kërkoj nga ministria si bartëse e proceseve që nëse është e mundur që një afat sa më të shkurtër ta kemi një informacion më të saktë, të gjithë e dimë se kriteret kanë qenë të shumta dhe të pa drejta dhe data kur e pritnim ta marrim një përgjigje për liberalizim, nuk ndodhi. Një ditë përpara e kishim një vizitë të rëndësishme të përfaqësuesve të BE-së, Komisionit Evropian, drejtoresha politike për Ballkanin përfundimtar shumë qartë na i ka thënë brengat nga ato që në i dëgjojmë çdo ditë si opozitë si skandale të Qeverisë, pjesa e fundit është rritja e pagave pa konsultim paraprak dhe pa dakordim ndërkombëtar dhe pa e përfillur sugjerimin e tyre e që është reforma në administratën publike dhe me e prit ligjin për pagat i cili është duke u diskutuar, me u harmonizuar me qëndrimet edhe të subjekteve tjera për të ardhën në një afat të shkurtër kohor që ta kemi një përgjigje të saktë se si do të vendos Kuvendi rreth këtyre pagave. Shqetësuese është kur kemi zëra brenda Qeverisë së Kosovës nga individ kur e sugjerojnë BE-në që nuk është punë e tyre rritja e pagave në Republikën e Kosovës, ndërsa në anën tjetër edhe sot po flasim për asistencë të fondeve monetare që i jep Kosovës Komisioni Evropian, 22 Mil derdhen direkt në buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërsa Qeveria në mënyrë të një anshme rrit pagat për një grup të



caktuar brenda qeverisë. Kjo është ajo që na bën neve skeptik për një përgjigje pozitive, por iniciativat ligjore pa dakordim me BE-në kanë lënë shije te keqe në këtë të fundit.

Në vazhdim tha lus komisionin që t'ju thërrasin ministre që ta kemi një qartësim të këtij pozicioni se me të vërtet jemi në një gjendje ku askush nuk po dinë me dhënë një përgjigje të saktë dhe qytetarët janë në terr informativ sa i përket datës së liberalizimit të vizave.

Lidhur me marrëveshjen sugjeroj që të presim deri sa të merrni një përgjigje për letrën që e keni dërguar dhe të vini në Komision dhe tek atëherë t'i japim dritën jeshile kësaj marrëveshje, sepse kjo marrëveshje nuk është vetëm për trajnim të rinjve, por kjo është edhe për ne, si vendim marrës të politikave që ka të bëjë me Kuvendin e Kosovës dhe komisionin për MSA-në dhe për stafin e juaj politik që merret me këto politika dhe do të ishte e drejtë që të përfitojë.

**Zenun Pajaziti**, mendon se asistenca teknike për administratë është ide e mirë, shpesh herë ideja që fondet me u derdh të pjesa politike janë kritikuar nga opozita, nuk e di sa mundën të stafi politik. Ne jemi të përkohshëm dhe insistoj me fuqizuar kërkesën time për me pasur diçka të qëndrueshme dhe mendoj se ju ministre e dini më së miri se në çfarë mënyre këtë asistencë me e bërë diçka që ka qëndrueshmëri, sepse kjo fazë është shumë e rëndësishme .

**Fatmire Kollçaku**, tha se bazuar ne historianin e shfrytëzimit të ndihmave dhe të fondeve. Ne shprehim dyshime se ato mjete shfrytëzohen adekuat për çka janë destinua, ministria vetëm nuk mund të bëjë asgjë nëse nuk e ka mbështetjen e krejt Qeverisë.

Sa herë që kjo Qeveri deklaroi se jemi afruar në përmbushjen e kriterëve, menjëherë e fut veten në lajthitje. Ne e thamë që vendimi për paga ka qenë autogoli me i madh i kësaj Qeverie dhe keqpërdorimi i fondeve publike, është normale që donatorët brengosen për fondet që i sjellin këtu, mungon reforma në administratën publike sepse vazhdimisht sjellin staf politik, ne do të duhej të ishim tani në një fazë ku do të kishim staf të trajnuar mjaft, kurse asistencat të shfrytëzohen për qëllime tjera.

**Kryetarja**, në fund të diskutimeve të deputetëve konstatoj nxori këtë:

### **Përfundim**

Pasi që ministrja ka dërguar një letër për plotësim dhe ndryshim të Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në Kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistencë Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian, atëherë komisioni të pret deri sa ministria të merr një konfirmim të qartë dhe pastaj të kthehet marrëveshja në komision për shqyrtim dhe të përcillet në seancën plenare.

**Ministrja**, tha se mbetet e hapur për bashkëpunim dhe është e gatshme kur do që komisioni e gjen kohën të ulen e të diskutojnë për hapat e ardhshëm të liberalizimit të vizave, si dhe ti koordinojnë agjendat mos të ketë zvarritje të pa nevojshme të liberalizimit të vizave.

#### **4. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores së Kuvendit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**Kryetarja**, tha se miratimi i kësaj Rregulloreje është paraparë edhe si masë legjislative në kuadër të programit kombëtar të zbatimit të MSA-së, sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, fusha e cila rregullon këtë Projekt-rregullore me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së, por është çështje e brendshme që e rregullojnë shtetet veç e veç. Duke pas parasysh që procesi i integritimit është proces dinamik, propozoi që në kapitullin 16, ku flitet për procesin e integritimit të paraqesim 8 amendamentet që i keni përpara dhe të përfshihen në rregulloren e re.

Pas votimit të anëtarëve të komisionit, kryetarja konstaton se komisioni nxori këtë:

#### **Rekomandim**

**Miratohet Projekt-Rregullorja e Kuvendit, me amendamentet e Komisionit Funkcional si dhe 8 amendamentet e propozuara nga Komisioni për Integritim Evropian dhe i propozohet Kuvendit për miratim**

#### **5. Të ndryshme;**

**Kryetarja**, për këtë pikë tha se në takimin e fundit kemi diskutuar për një konferencë që do ta mbaj DICAf për çështjen e Projektligjit për përgjimet e telekomunikimeve elektronike dhe pjesë e kësaj është edhe Komisioni për Integritim Evropian dhe Komisioni për Siguri dhe pasi që data 5 ka qenë datë kur kemi pasur edhe seancë, andaj ka mbetur pa u definuar qartë se a do të jemi pjesë ose jo. Kam diskutuar me kryetarin e Komisionit për Siguri dhe na është thënë se ata nuk e kanë monitoruar projektligjin dhe nuk kanë rekomandime.

Nga Komisioni për Integritim na është kërkuar që të jetë udhëheqës i panelit dhe në ende nuk e kemi definuar se kush do të jetë. Lidhur me këtë hapi diskutimin.

**Fatmire Kollçaku**, tha se ne kemi diskutuar dhe nuk e kemi iniciuar monitorimin e këtij Ligji dhe jemi dakorduar që edhe ne ta bëjmë monitorimin e këtij Ligji.

Mendoj se ky komision duhet të jetë me aktiv dhe ta shikojmë Planin e punës se a kemi arritur ta plotësojmë. Ne duhet ta shfrytëzojmë edhe buxhetin e komisionit për një ekspert i cili në mënyrë të pa varur do ta bëjë analizën se çfarë është bërë për liberalizimin e vizave, ku qëndrojmë sepse raportet që po na vijnë nga ministrat po na vijnë me vonesë dhe nuk po jemi në hap ta shfrytëzojmë edhe asistencën e GIZ-it dhe mendoj si komision një ditë pune t'ia kushtojmë para se të shkoj Kuvendi në pushim ta shohim ku jemi dhe çka do të bëjmë në të ardhmen.

**Kryetarja**, tha se plani i punës së komisionit i votuar nga deputetët e komisionit është zbatuar në tërësi dhe natyrisht që neve na dalin edhe agjenda të reja evropiane dhe ne jemi të detyruar ta zhvendosim agjendën tonë, jo vetëm GIZ-i por edhe çdo organizatë që është e

interesuar ta mbështes komisionin është e mirëseardhur, ne mund të takohemi në një takim të përbashkët për të diskutuar se nëse ka dikush për të shtuar dhe plotësuar planin e punës. Në fund kryetarja pyeti edhe një herë anëtarët të deklarohen se kush do të marrë pjesë në konferencë.

**Milaim Zeka**, u deklarua se do të marrë pjesë.

**Armend Zemaj**, tha se pasi ftesa është për neve, si hartues të Ligjit për përgjimet elektronike, do të ishte mirë të marrim pjesë, por pengesë është se në të njëjtën ditë kemi seancë. Propozoj që në të ardhmen e afërt ta formojmë grupin punues ku mund ta implikojmë edhe GIZ-in që ta monitorojmë zbatimin e këtij Ligji.

**Kryetarja**, tha se i tërë komisioni është i ftuar dhe do të ishte mirë kush mundet me e gjetur kohën, të marrë pjesë në këtë konferencë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:35.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e komisionit**

**Kryetare e komisionit**

-----

**Blerta Deliu-Kodra**